EPOKA E RE
E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6546
E hënë, 28 shkurt 2022
çmimi 0.40

## Gjykata Speciale dhe idealizmi i Perëndimit!

Shkruan: Artan BEHRAMI

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

LUFTA NË UKRAINË RRIT VIGJILENCËN NË KOSOVË

# POZITË DHE OPOZITË KËRKOJNË PËRSHPEJTIM TË ANËTARËSIMIT TË KOSOVËS NË NATO



Përfaqësues të Qeverisë së Kosovës dhe të opozitës kanë kërkuar përshpejtim të anëtarësimit të Kosovës në NATO pas agresionit ushtarak të Rusisë në Ukrainë dhe reflektimit të tij në mjedisin e përgjithshëm të sigurisë së Ballkanit Perëndimor. Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka thënë se, krahas anëtarësimit të përshpejtuar të Kosovës në NATO, duhet të bëhet edhe vendosja e bazës së përhershme të Forcave Amerikane në vendin tonë

## Shënohen 81 raste me Covid brenda 24 orëve në Kosovë

FAQE 6






## UKRAINA DHE RUSIA PAJTOHEN TË BISEDOJNË PA PARAKUSHTE

FAQE 3

### AKTUALE



**KRYETARI I KIEVIT: NUK KA TRUPA RUSE NË KRYEQYTET** F. 2

**POLICIA E KOSOVËS RRIT KAPACITETET NË VERI, SERBIA REAGON** F. 6

**KURTI UDHËTON NË LONDËR, MERR PJESË NË SAMITIN PËR INVESTIME NË BALLKANIN PERËNDIMOR** F. 3

### EKONOMI




**BSPK-ja: DRAFTLIGJI I PAGAVE ËSHTË I PAPRANUESHËM, DISKRIMINON PUNËTORËT** F. 8

**ÇMIMI I BUKËS PRITET TË RRITET PËR 70 PËR QIND** F. 8

### SPORT



**KOSOVA PËSON HUMBJE NGA NORVEGJIA** F. 8

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel:+389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax:+389 44 487 200
Mob:+377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# Ukraina dhe Rusia pajtohen të bisedojnë pa parakushte

"Ne jemi pajtuar që delegacioni ukrainas të takohet me delegacionin rus pa parakushte në kufirin në mes të Ukrainës dhe Bjellorusisë, afër Lumit Pripjat", është bërë me dije nga zyra e presidentit ukrainas



**Kiev, 27 shkurt** - Zyrtarët ukrainas dhe ata rusë do të takohen në kufirin bjellorus me Ukrainën për të biseduar, ka thënë të dielën zyra e presidentit e Ukrainës, Volodymyr Zelenskiy.
Këto bisedime, të parat prej kur Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt, do të mbahen pa parakushte dhe janë rezultat i një bisede telefonike në mes të Zelenskyit dhe presidentit bjellorus Alyaksandr Lukashenka, ka thënë zyra e presidentit ukrainas, transmeton agjencia e lajmeve "Reuters". "Ne jemi pajtuar që delegacioni ukrainas të takohet me delegacionin rus pa parakushte në kufirin mes



Ukrainës dhe Bjellorusisë, afër Lumit Pripjat", është thënë përmes një deklarate.
Lukashenka "ka marrë përgjegjësinë për të siguruar që të gjithë avionët, helikopterët dhe raketat e stacionuara në territorin bjellorus të qëndrojnë në tokë gjatë udhëtimit, bisedimeve dhe kthimit të delegacionit ukrainas", tha Zyra e Zelenskyit.
Më herët zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, tha se një delegacion rus kishte mbërritur në Bjellorusi për negociata. Delegacioni përbëhet nga zyrtarë të Ministrisë së Jashtme, Ministrisë së Mbrojtjes dhe entiteteve të tjera ruse, përfshirë stafin presidencial, raportoi "Tass".
Zelensky ka thënë më herët se nuk do të takohet me delegacionin rus në territorin bjellorus, sepse pushtimi i Rusisë është nisur edhe nga pjesë të Bjellorusisë.
As Rusia, as Bjellorusia nuk kanë lëshuar deklarata për negociata eventuale.
Presidenti rus Vladimir Putin ka urdhëruar ushtrinë që t'i vendosë forcat parandaluese të Rusisë - referencë për njësitet që përfshijnë krahun bërthamor - në gatishmëri të lartë, duke cituar ato që i ka konsideruar deklarata agresive të liderëve të NATO-s, dhe sanksionet ekonomike kundër Moskës. "Siç mund ta shihni, jo vetëm shtetet e Perëndimit marrin masa jomiqësore kundër shtetit tonë në dimensionin ekonomik - dua të them sanksionet ilegale që të gjithë i dinë - por edhe zyrtarët e lartë të NATO-s ia lejojnë vetes të bëjnë deklarata agresive sa i përket shtetit tonë", ka thënë Putini për televizionin shtetëror.



Liderët e Bashkimit Evropian, Francës, Gjermanisë, Italisë, Britanisë, Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara, janë pajtuar për të bllokuar disa banka ruse në sistemin bankar, SWIFT, si dhe që të vendosin "masa kufizuese" kundër Bankës Qendrore të Rusisë për sulmin në Ukrainë.
Në një deklaratë të përbashkët më 26 shkurt, liderët kanë thënë se masat të cilat do t'i kufizojnë rezervat ndërkombëtare të Bankës Qendrore ruse dhe do ta pengojnë atë në mbështetjen e rublës do të zbatohen në ditët në vijim.
Ekspertët kanë thënë se bllokimi i qasjes në sistemin SWIFT do ta rrisë intensitetin e sanksioneve të Perëndimit kundër Moskës. Sulmi i Moskës ndaj Ukrainës ka nisur në orët e para të 24 shkurtit.
Raketat janë nisur në aeroporte dhe infrastrukturë ushtarake në rreth 25 qytete.
Presidenti rus, Vladimir Putin, ka urdhëruar "operacion special" për ta çmilitarizuar Ukrainën.
Veprimi i Kremlinit ka nxitur zemërim dhe është dënuar në gjithë botën.
Shtetet e Bashkuara dhe aleatët janë përgjigjur me sanksione të ashpra kundër Moskës.

### Kryetari i Kievit: Nuk ka trupa ruse në kryeqytet

Kryetari i Kievit, Vitali Klitschko, ka thënë se në kryeqytetin ukrainas nuk ka trupa ruse. Ai ka thënë se zyrtarë "ushtarakë, ata për zbatim të ligjit dhe mbrojtja territoriale" janë duke vazhduar "vëzhgimin dhe neutralizimin e sabotuesve".
"Siç kemi raportuar më herët, njerëzit në Kiev janë urdhëruar që të qëndrojnë brenda deri të hënën, me paralajmërime nga autoritetet se kushdo që del jashtë do të konsiderohet anëtar i grupeve sabotuese nga ana e armikut".
Klitschko ka thënë për transmetuesin britanik "BBC", se prej nisjes së pushtimit rus 31 persona kanë vdekur në kryeqytet, prej tyre nëntë civilë.
Forcat ruse është raportuar se janë në afërsi të Kievit prej të premtes.

### Putini vendos forcën bërthamore në gatishmëri të lartë

Presidenti rus Vladimir Putin ka urdhëruar ushtrinë që t'i vendosë forcat parandaluese të Rusisë - referencë për njësitet që përfshijnë krahun bërthamor në gatishmëri të lartë, duke cituar ato që i ka konsideruar deklarata agresive të liderëve të NATO-s dhe sanksionet ekonomike kundër Moskës, transmeton "Reuters". "Siç mund ta shihni, jo vetëm shtetet e Perëndimit marrin masa jomiqësore kundër shtetit tonë në dimensionin ekonomik, dua të them sanksionet ilegale që të gjithë i dinë, por edhe zyrtarët e lartë të NATO-s ia lejojnë vetes të bëjnë deklarata agresive sa i përket shtetit tonë", ka thënë Putini për televizionin shtetëror.
Putini urdhëroi ministrin e Mbrojtjes të Rusisë dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë që t'i vendosnin forcat e parandalimit bërthamor në një "regjim të posaçëm të detyrës luftarake", që do të thotë se armët bërthamore të vendit do të ishin në gjendje të shtuar gatishmërie për t'u lëshuar.
Urdhri ngriti menjëherë shqetësimet se tensionet me Perëndimin mund të çonin në përdorimin e armëve bërthamore.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Gjykata Speciale dhe idealizmi i Perëndimit!



Shkruan: Artan BEHRAMI

Lufta në Ukrainë dëshmon se idealizmi i Perëndimit ishte një gabim historik dhe dështim moral i një brezi të madh të politikanëve në shtetet perëndimore.
Perëndimi i shekullit 21 krijoi, financoi dhe jetësoi Gjykatën Speciale - një gjykatë hibride, sui-generis, për t'ia dëshmuar Rusisë dhe Putinit se do të hetojë rrëfimet fanta-shkencë të senatorit Dick Marty.
Perëndimi, siç do të dëshmojë e ardhmja, përmes Këshillit të Evropës legjitimoi një raport, i përbërë nga dezinformata ruse, duke u bërë kështu dokumenti i parë "fake news" në botë!
Pas 22 viteve të proceseve gjyqësore të njëpasnjëshme kundër luftë sonë, Perëndimi i shekullit 21 dëshironte ta rishkruajë edhe historinë e Perëndimit të shekullit 20, i cili mbështeti UÇK-në kundër Milloshevicit.
Tani që po e përjeton luftën, tmerrin dhe krimet e Putinit në paraderën e tij, Perëndimi është duke armatosur Ukrainën për të fituar luftën në emër të tyre!
Tani, Perëndimi duhet ta kuptojë që gjykimi i UÇK-së është sikur gjykimi i ushtrisë së Ukrainës (me shumë dallime), që vetëmbrohet nga agresioni rus, madje me ndihmën dhe armët e Perëndimit.
Tani, Perëndimi duhet ta kuptojë që gjykimi i krerëve të UÇK-së është sikur gjykimi nesër i udhëheqësve të Ukrainës, që luftojnë për lirinë e vendit të tyre, për lirinë dhe demokracinë në Evropë!
Në rrethana të tilla, minimum që mund të bëjë Perëndimi sot është të sigurohet që krerët e UÇK-së do të kenë një gjykim fer dhe të paanshëm.
Jo një gjykim politik, që synon t'i mbajë ata me vite të tëra në një proces gjyqësor, ku në fund dalin të pafajshëm!
Sepse, edhe më tutje, Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe krejt UÇK-ja janë aleatë të Amerikës, NATO-s, Bashkimit Evropian dhe tërë botës perëndimore.

# Kurti udhëton në Londër, merr pjesë në Samitin për Investime në Ballkanin Perëndimor

**Prishtinë, 27 shkurt (ER)** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka udhëtuar për në Britani. Sipas njoftimit të Zyrës së Kryeministrit, Kurti, nesër (e hënë), më 28 shkurt 2022, do të marrë pjesë në Samitin për Investime në Ballkanin Perëndimor 2022 në Londër. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) do t'i presë kreun e Qeverisë së Shqipërisë, të Bosnjë Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë në Samitin e saj të Investimeve në Ballkanin Perëndimor 2022, të hënën më 28 shkurt.
Në samit do të marrin pjesë: Ana Brnabiq, kryeministre e Serbisë; Dimitar Kovaçevski, kryeministër i Maqedonisë së Veriut; Zdravko Krivokapiq, kryeministër i Malit të Zi; Albin Kurti, kryeministër i Kosovës; Edi Rama, kryeministër i Shqipërisë; Zoran Tegeltija, kryetar i Këshillit të Ministrave të Bosnjës Hercegovinës; dhe Odile Renaud-Basso, president i BERZh-it.
Në këtë samit do të mbajë një fjalim edhe komisionari i BE-së për Zgjerimin, Oliver Varheli.
Ky është samiti i pestë i BERZh-it i këtij lloji, i cili mblodhi së bashku të gjithë kryeministrat e rajonit për herë të parë në shkurt 2014. Qëllimi i samitit është të nxjerrë në pah mundësitë e investimeve dhe të biznesit dhe ta promovojë lidhjen rajonale.



# Tentuan të udhëtojnë me dokument fals, arrestohen tri gra në Aeroportin e Prishtinës

**Prishtinë, 27 shkurt (ER)** - Tri gra janë arrestuar gjatë ditës në Aeroportin e Prishtinës, dy nga to, sipas policisë, janë shtetase të huaja, ndërsa njëra shtetase e Kosovës. Të gjitha, sipas policisë, dyshohen se kanë tentuar të udhëtojnë në një shtet të Evropës me dokument të falsifikuar.
Dy nga të dyshuarat me vendim të prokurorit janë dërguar në mbajtje, ndërsa njëra është liruar. "Është arrestuar e dyshuara femër shtetase e huaj e cila përmes aeroportit dyshohet se ka tentuar të udhëtojë nga Prishtina në një shtet të Evropës me dokument të falsifikuar (pasaportën e një shteti tjetër). E dyshuara me vendim të prokurorit është dërguar në mbajtje. Është arrestuar e dyshuara femër shtetase e huaj e cila përmes aeroportit të Prishtinës dyshohet se ka tentuar të udhëtojë në një shtet të Evropës me dokument të falsifikuar (pasaportën e një shteti tjetër. E dyshuara me vendim të prokurorit është dërguar në mbajtje). Është raportuar se e dyshuara femër shtetase e Kosovës përmes aeroportit të Prishtinës dyshohet se ka tentuar të udhëtojë në një shtet të Evropës me dokument të falsifikuar (leje qëndrimin të huaj). E dyshuara, në konsultim me prokurorin, është liruar. Rasti procedohet në procedurë të rregullt", ka njoftuar Policia e Kosovës.



LUFTA NË UKRAINË RRIT VIGJILENCËN NË KOSOVË

# Pozitë dhe opozitë kërkojnë përshpejtim të anëtarësimit të Kosovës në NATO

Përfaqësues të Qeverisë së Kosovës dhe të opozitës kanë kërkuar përshpejtim të anëtarësimit të Kosovës në NATO pas agresionit ushtarak të Rusisë në Ukrainë dhe reflektimit të tij në mjedisin e përgjithshëm të sigurisë së Ballkanit Perëndimor. Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka thënë se, krahas anëtarësimit të përshpejtuar të Kosovës në NATO, duhet të bëhet edhe vendosja e bazës së përhershme të forcave amerikane në vendin tonë

EPOKA E RE Mal QORRAJ

**Prishtinë, 27 shkurt** - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka thënë të dielën se anëtarësimi i përshpejtuar i Kosovës në NATO dhe vendosja e bazës së përhershme të forcave amerikane është nevojë për garantimin e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë. "Bazuar në realitetin e krijuar pas agresionit ushtarak të Rusisë në Ukrainë dhe reflektimit të tij në mjedisin e përgjithshëm të sigurisë së Ballkanit Perëndimor, Evropës dhe Botës, kërkojmë nga ShBA-ja dhe të gjitha vendet aleate dhe partnere të vendit, përshpejtimin e procesit të anëtarësimit të Republikës së Kosovës në NATO. Republika e Kosovës dhe qytetarët e saj, kemi dëshmuar dhe konfirmojmë qëndrimin dhe vendosmërinë e fuqishme, që jemi luftëtarë të denjë në mbrojtje të vlerave euroatlantike të lirisë, paqes dhe demokracisë, vlera mbi të cilat qëndron NATO dhe misioni i saj", ka thënë Mehaj.

Ai u ka bërë thirrje aleatëve të Kosovës dhe vendeve anëtare të NATO-s, që hezitojnë në njohjen e realitetit shtetëror të Republikës së Kosovës, mos të hezitojnë më. "Kjo është koha që të gjitha kombet e përgjegjshme të mos përjashtojnë askënd në vizionin e përbashkët dhe para së keqes së përbashkët. Kosova dhe populli i saj, në këtë kohë, të sfidës së përbashkët, si gjithmonë, qëndrojmë fuqishëm së bashku me ju në anën e duhur të historisë. Gjithashtu, është koha të ripërsëris edhe tani, kërkesën time adresuar aleatit tonë të pazëvendësueshëm, ShBA-së, për vendosjen e Bazës së Përhershme Ushtarake të Forcave Amerikane, si garanci e plotë e paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe më gjerë. Ne, së bashku, jemi plotësisht të vetëdijshëm për sfidat, kërcënimet dhe rreziqet potenciale, andaj të veprojmë sot që ta parandalojmë keqen e paparashikueshme për rajonin, kontinentin dhe globin edhe nga kjo anë", ka thënë ministri Mehaj.

Edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka shprehur nevojën dhe domosdoshmërinë që ka Kosova për t'u anëtarësuar në Aleancën Veriatlantike. Abdixhiu në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar që bashkimi i deritanishëm i NATO-s si reagim ndaj agresionit rus në Ukrainë është një mundësi shumë e mirë edhe për Kosovën për t'i anëtarësuar në këtë aleancë.

Ai ka thënë se Gjermania sot rriti buxhetin për mbrojtje në rekordet më të larta të shtatë dekadave të fundit, në 2 për qind të Bruto Produktit Vendor, e 100 miliardë euro investime vetëm këtë vit. "Vendet e mbetura të BE-së tani kërkojnë anëtarësim të plotë në NATO. Doktrina 'paqe nëpërmjet forcës" - e presidentit Reagan, po rikthehet me të drejtë në Evropë. Më 17 korrik të vitit 1980, në Konventën Republikane të kohës, ai thoshte: 'Ne e dimë shumë mirë se lufta nuk vjen kur forcat e lirisë janë të forta, por kur ato janë të dobëta. Pikërisht atëherë tiranët tundohen'. Putini është shembull i një tundimi të tillë. Aleatët e tij në Serbi janë shembull të një tundimi të tillë", ka thënë ai.

Abdixhiku ka theksuar se bashkimi i tanishëm euroatlantik si reagim ndaj tiranisë ruse mbi Ukrainë

është një dritare historike për Kosovën. "Anëtarësimi ynë në NATO sot ka një mundësi të re. Kosova, institucionet tona, diplomacia jonë, duhet të shfrytëzojnë këtë dritare historike që rrallëherë na hapet kaq shumë, e aleatët tanë ndërkombëtarë duhet ta përshpejtojnë anëtarësimin tonë si proces të natyrshëm të sigurisë evropiane. Kosova në NATO është domosdoshmëri; gjithnjë ka qenë, gjithnjë do të jetë. Le të shfrytëzojmë këtë moment të ri për një hap të madh historik. Le t'i nxisim të gjitha potencialet tona në këtë drejtim", ka thënë Abdixhiku.

Kreu i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se Kosova duhet të qëndrojë fuqishëm në krah me ShBA-në, BE-në dhe Ukrainën dhe se nuk duhet të bëhemi pre e provokimeve. Në një shkrim në "Facebook", Haradinaj ka thënë se agresioni rus ndaj Ukrainës është një skenar nëpër të cilin ka kaluar Kosova gjatë kohës së Milloshevigit. "Kosova duhet të qëndrojë fuqishëm në krah me ShBA-në, BE-në dhe Ukrainën. Nuk duhet të bëhemi pre e provokimeve me të cilat po përballemi edhe ne. Lufta me dezinformata dhe lajme të rrejshme nuk na kursen as neve, andaj edhe duhet të jemi të kujdesshëm. Agresioni rus ndaj Ukrainës është një skenar nëpër të cilin ka kaluar Kosova gjatë kohës së Milloshevigit. Fatkeqësisht ky agresion vazhdon nga Putini dhe aleatët e tij në shtetet e tjera edhe me pozicionin e tij për armët bërthamore. Bota demokratike tashmë e di se agresorët si Milloshevigi dhe Putini janë kundër vlerave tona të përbashkëta dhe të njëjtët i humbin luftërat", ka shkruar Haradinaj.

Ai ka thënë se vitin e kaluar pati theksuar se Kosova nuk mund të presë pafundësisht për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, veçanërisht në Aleancën Veriatlantike. "Me urgjencë duhet të kthehet projekti i gazsjellësit amerikan, të përfundojë Strategjia Nacionale e Sigurisë si dhe të procedohet në Kuvend Ligji për Fondin për Mbrojtje (donacionet për Ushtrinë e Kosovës). Të gjitha këto, krahas anëtarësimit tonë në NATO, do të krijojnë një realitet të ri të sigurisë në rajon dhe një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët e vendit.

Për këto arsye do të kërkoj debat parlamentar rreth situatës së sigurisë në vend. Kjo situatë nuk duhet ta gjejë në gjumë qeverinë aktuale, por e njëjta duhet të angazhohet që këtë situatë ta shfrytëzojë sa më mirë, në dobi të Kosovës dhe qytetarëve", është shprehur Haradinaj.

Ish-komandanti i Forcave të Sigurisë së Kosovës, Kadri Kastrati, vlerëson se Qeveria e Kosovës ka reaguar me vonesë në lidhje me agresionin rus në Ukrainë e cila mund të reflektojë edhe në Kosovë. Kastrati thotë se kryeministri Albin Kurti vetëm para disa ditësh ka mbledhur Këshillin e Sigurisë së Kosovës e, siç thotë ai kjo, do të duhej të ndodhte më herët. Ai shprehet se si situata e luftës në Ukrainë nga Rusia mund të ndikojë veçanërisht në veri të Kosovës. "Unë mendoj që kanë reaguar me vonesë për arsye që deri para dy ditësh kryeministri e ka mbledhur Këshillin e Sigurisë Kombëtare. Ne e dimë që mbi një muaj Rusia ka grumbulluar mbi 160 mijë ushtarë, pajisje, armatime rreth Ukrainës dhe është parë që më tepër se një muaj se Rusia dëshiron dhe ka për qëllim ta okupojë Ukrainën dhe është dashur që Qeveria e Republikës së Kosovës ta mbledhë më herët Këshillin e Sigurisë Kombëtare dhe ta analizojë situatën dhe të marrë masa adekuate për të marrë të gjitha veprimet e nevojshme në rast se lidhet apo në rast që reflektohet ajo krizë dhe lufta që ka filluar atje dhe që reflekton në Kosovë që të ketë një plan paraprak, çka duhet të veprojë dhe si duhet të veprojë në lidhje me situatën", ka thënë Kastrati për "KosovaPress".

Ai ka bërë thirrje që institucionet e Kosovës duhet të jenë në koordinim me KFOR-in, NATO-n, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe me partnerët e saj strategjikë.

Pas shpërthimit të luftës në Ukrainë, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, dhe kryeministri Albin Kurti kanë thënë se kanë marrë masa shtesë për sigurinë. Ata nuk kanë dhënë detaje rreth tyre, por kanë njoftuar për një varg takimesh që kanë zhvilluar me përfaqësuesit e mekanizmave të sigurisë - vendorë e ndërkombëtarë.

Më 23 shkurt Këshilli i Sigurisë i Kosovës ka mbajtur një takim. Sipas zëdhënësit të qeverisë, Përparim Kryeziu, ky takim ka prodhuar disa konkluzione në lidhje me bashkëpunimin midis Kosovës dhe partnerëve nga Bashkimi Evropian, NATO-ja, Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëria e Bashkuar, por "detajet nuk mund të bëhen publike" për shkak të "ndjeshmërisë së situatës". "Kosova rrethohet nga tri vende anëtare të NATO-s [Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut], ndërsa e ka NATO-n brenda me rreth 3 700 ushtarë nga 28 vende aleate. Në të njëjtën kohë, e kemi edhe Forcën e Sigurisë [së Kosovës], e cila çdo ditë e më shumë po avancohet, sidomos falë bashkëpunimit me ShBA-në dhe NATO-n", ka thënë Kryeziu. Forcat e NATO-s janë të pranishme në Kosovë qysh në qershor të vitit 1999, pas përfundimit të luftës dhe tërheqjes së forcave serbe.



## Shënohen 81 raste me Covid brenda 24 orëve në Kosovë



**Prishtinë, 27 shkurt (ER)** - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, janë shënuar 81 raste pozitive të Covid-19. Sipas MSh-së, brenda 24 orëve janë testuar 1 699 persona. Po ashtu, brenda këtij periudhe janë dhënë 329 doza të vaksinës.
Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 812 571 doza të vaksinës. Deri më sot 815 710 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë, kurse janë dhënë 97 340 doza përforcuese dhe doza të treta.
Gjatë 24 orëve të fundit është shënuar një rast i vdekjes.
Të dielën janë shëruar 403 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 221 022.
Në total numri i rasteve aktive është 2 058.

# Policia e Kosovës rrit kapacitetet në veri, reagon Serbia

**Prishtinë, 27 shkurt** - Policia e Kosovës njoftoi të shtunën se ka dërguar “pajisje logjistike dhe kontejnerë” në vendkalimin kufitar Bërnjak, të cilat, siç tha, do t’i shërbejnë policisë kufitare. Në njoftim thuhet se Policia e Kosovës “po punon ekskluzivisht në interes të sigurisë së qytetarëve dhe krijimit të një ambienti të sigurt”.
Bërnjaku ndodhet në veri të Kosovës, pjesë e banuar me shumicë serbe.
Pas nisjes së sulmeve ruse në Ukrainë, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, dhe kryeministri Albin Kurti thanë se kanë marrë masa shtesë të sigurisë.
U bë e ditur se ata kanë takuar përfaqësues të mekanizmave të sigurisë - vendorë e ndërkombëtarë - por nuk u dhanë detaje as për takimet, as për masat.
Zyra për Kosovën e Qeverisë së Serbisë tha të shtunën se “aksioni i fundit policor në veri të Kosovës është në kundërshtim me marrëveshjet e vlefshme”.
Qëllim i këtij aksioni, sipas saj, është “provokimi i rrezikshëm” dhe “destabilizimi i situatës në terren”.
Në deklaratën e kësaj zyre thuhet se Policia e Kosovës, 80 metra nga vendkalimi në Bërnjak, ka sjellë “makineri të rënda dhe njerëz” me “pretekstin e forcimit të postbllokut policor në vendkalim”. “Veprime të tilla të njëanshme dhe të papërgjegjshme të Prishtinës kanë vetëm një qëllim: të provokojnë një destabilizim të ri të situatës në terren, në një moment shumë të ndjeshëm për sigurinë, me të cilin po përballet e gjithë bota”, thuhet në deklaratën e Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë.
Ajo tha se i bën thirrje Prishtinës që të mos e provokojë Beogradin dhe serbët në Kosovë dhe të mos rrezikojë paqen dhe sigurinë, duke shkelur marrëveshjen.
Dy pikat kufitare me Serbinë në veri të Kosovës - Jarina dhe Bërnjaku - u bllokuan nga serbët lokalë për dy javë në



shtator të vitit të kaluar. Kjo ndodhi për shkak të një vendimi të Qeverisë së Kosovës për të vendosur masa reciprociteti ndaj automjeteve me targa të Serbisë.
Kosova dhe Serbia më pas gjetën një zgjidhje të përkohshme përmes Bashkimit Evropian. Dy vendet vendosën t’i mbulojnë simbolet shtetërore në targa deri në një zgjidhje përfundimtare. Kosova dhe Serbia kanë më shumë se një dekadë që zhvillojnë negociata për normalizimin e marrëdhënieve me ndërmjetësimin e BE-së.

# Ministri Mehaj takon komandantin Kajar, kërkon më shumë trupa të KFOR-it në veri



**Prishtinë, 27 shkurt (ER)** - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka njoftuar se me qëllim të koordinimit të ngushtë me KFOR-in, pas agresionit ushtarak të Rusisë mbi Ukrainën, në Shtabin e Përgjithshëm të KFOR-it është takuar me komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Ferenc Kajar.
Mehaj ka shkruar në “Facebook” se ka kërkuar prani më të madhe të trupave të KFOR-it në pjesën veriore të Kosovës dhe përforcim më të madh të kontingjentit të saj. “Kërkova prani më të madhe të trupave të KFOR-it në pjesën veriore të Kosovës dhe përforcim më të madh të kontingjentit të saj. Gjithashtu, me gjeneral Kajar u pajtuam që të rritet koordinimi në mes të institucioneve të sigurisë së vendit dhe KFOR-it, si dhe që të shtohen kapacitetet dhe vigjilenca në gjithë kufirin e vendit. Tendencat destabilizuese të Rusisë dhe satelitëve të saj ndaj vendit tonë dhe rajonit të Ballkanit Perëndimor tashmë janë të qarta dhe atyre do t’i kundërvihemi së bashku me aleatët tanë”, ka njoftuar Mehaj.

## Rrezik për ortek, mbyllet Qendra e Skijimit në Brezovicë

**Prishtinë, 27 shkurt** - Policia e Kosovës ka njoftuar se Qendra e Skijimit në Brezovicë është mbyllur të dielën për vizitorët për shkak të rrezikut të ndonjë orteku të mundshëm. Sipas policisë, kjo është bërë për shkak të të reshurave dhe kushteve atmosferike në këtë pjesë. “Nga Qendra e Skijimit në Brezovicë jemi njoftuar se, për shkak të të reshurave atmosferike dhe rrezikut që u kanoset qytetarëve nga ndonjë ortek bore, Qendra e Skijimit në Brezovicë është mbyllur sot për vizitorë. Patrullat e policisë do të jenë tek udhëkryqi i rrugës që çon për në Qendrën e Skijimit në Brezovicë dhe te laura ku fillon Parku Nacional ‘Sharr’ dhe do të ndalohen të gjitha automjetet e vizitorëve”, ka bërë me dije Policia e Kosovës.



# BSPK-ja: Draftligji i Pagave është i papranueshëm, diskriminon punëtorët

**Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) dhe Sindikata e Zjarrfikësve kanë shprehur pakënaqësi me Ligjin e ri të Pagave. Përfaqësuesit e këtyre sindikatave po kërkojnë nivelizim me shërbimet e tjera**

PRISHTINË, 27 SHKURT - Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) dhe Sindikata e Zjarrfikëseve kanë shprehur pakënaqësi me Ligjin e ri të Pagave. Ata po kërkojnë nivelizim me shërbimet e tjera, pasi thonë se ata janë të gatshëm të jenë në shërbim të popullit, por jo në shërbim të neglizhencës.
Atdhe Hykolli nga BSPK-ja thotë se është i papranueshëm Ligji i ri për Paga, pasi që diskriminon punonjësit e Kosovës. "BSPK-ja është pjesë e Ligjit të Pagave. Ne kemi biseduar vetëm për pjesën e parë të draftit. BSPK-ja i ka pasur edhe konkluzionet e veta, ndërsa pjesa tjetër - shtojcat që kanë dalë në publik - për ne janë të papranueshme dhe nuk i pranojmë në formën që kanë dalë në mjetet e informimit. Ne jemi pjesë e komisionit, ne kemi pasur një takim dhe po presim pjesën zyrtare që vetë ata kanë deklaruar se do të na dërgojnë dhe diskutojmë. Ky ligj është i papranueshëm për ne sepse i diskriminon punonjësit e




Kosovës", thotë Hymolli.
Sa i përket ndarjes së kategorive, ai shprehet se të gjitha kategoritë e punonjësve janë nënvlerësuar nga drafti që ka dalë, përveç asaj politike. Ndërsa i pyetur se a do të ketë ndonjë protestë për këto pakënaqësi, Humolli nuk e ka mohuar, pavarësisht se ka thënë se është duke u munduar të dialogojë për këtë çështje.
Muharrem Beka nga Sindikata e Zjarrfikëseve ka thënë se, pavarësisht shpresës për favorizimin e Ligjit të Pagave, ata ndihen si një kategori që përfiton më së paku nga buxheti i Kosovës. Një ndër kërkesat e tyre është nivelizimi me shërbimet e tjera të sigurisë pasi që, sipas tij, ndihen të disfavorizuar në raport me ata.
Ai theksoi se zjarrfikësit në përgjithësi janë të gatshëm të jenë çdoherë në shërbim dhe ndihmë të popullit, por jo edhe të gatshëm ta rrezikojnë shëndetin dhe jetën për shkak të neglizhencës së institucioneve.

# Furnizimi i rezervave shtetërore me mallra, pa procedurë të prokurimit



PRISHTINË, 27 SHKURT - Qeveria e Republikës së Kosovës ka mbajtur mbledhje elektronike në të cilën është miratuar kërkesa e Departamentit të Rezervave Shtetërore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që furnizimi me produkte të Rezervave Shtetërore të Mallrave të përjashtohet nga procedurat e prokurimit. Në njoftimin e qeverisë thuhet se gjatë vitit të kaluar dhe këtij viti Republika e Kosovës ka rritur sasinë e nevojshme të rezervave në përputhje me programin për rezervat shtetërore. "Vendimi i sotëm ka për qëllim lehtësimin e mëtejmë të furnizimit me produkte të rezervës shtetërore, sipas nevojave", thuhet në njoftim. Ministrja e Industrisë, Rozeta Hajdari dhe ministri i Financave, Hekuran Murati, sot në një konferencë për medie kanë thënë se Kosova ka mjaftueshëm rezerva shtetërore, duke përfshirë miellin dhe naftën.

## Çmimi i bukës pritet të rritet për 70 për qind

PRISHTINË, 27 SHKURT - Kryetari i Federatës Sindikale të Bujqve të Kosovës, Tahir Tahiri, ka thënë se për shkak të luftës në Ukrainë, çmimi i bukës në vendin tonë pritet të rritet deri në 70 për qind. Tahiri e ka arsyetuar parashikimin e tij me faktin se Republika e Kosovës furnizohet nga Serbia me grurë e kjo nga Ukraina, dhe kështu do të ndikojë që të shtrenjtohet mielli e më pas produktet e tjera. "Prodhimet e grurit në vend nuk i plotësojnë kërkesat më shumë se 30 për qind, andaj pjesa tjetër importohet", ka thënë Tahiri për "Klan Kosova". Ai vlerëson se kjo do të ndikojë të këtë ngritje të çmimit të bukës për 70 për qind.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Kosova pëson humbje nga Norvegjia

Prishtinë, 27 shkurt - Kosova ka pësuar humbje nga Norvegjia me rezultat 92:95 (27:15, 19:16, 18:25, 17:25, 11:14). "Dardanët" e nisën ndeshjen për mrekulli ndeshjen, duke pasur epërsi konstante, dhe në çerekun e parë ishin në epërsi të dyfishtë, 22:11, e më pas e thelluan në 27:15, sa përfundoi kjo pjesë. Basketbollistët e Kosovës e thelluan epërsinë në 30:15, dhe gjatë gjithë periodës së dytë e menaxhuan lojën dhe epërsinë, ku më e larta ishte 46:29, ndërsa pjesa e parë përfundoi 46:31. Por, në periudhën e tretë mysafirët ishin më të mirë, duke ngushtuar shifrat në vetëm pesë pikë, 56:51, megjithatë, tetë pikë radhazi nga vendasit bën që të shkëputen në 64:51, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 64:56. Në dhjetë minutat e fundit u zhvillua lojë interesante, ku norvegjezët rikthehen, duke ngushtuar shifrat dhe zhvillohet lojë dramatike deri në fund, ku koha e rregullt përfundoi 81:81. Lojë interesante u zhvillua edhe në pesë minutat shtesë, që përfundoi 92:95. Kosova ka një fitore dhe dy humbje, kurse Norvegjia dy fitore e një humbje në rrethin e parë parakualifikues për "Eurobasket 2025".



# Fitore e vështirë për Istogun në derbin ndaj Ferizajt

Istog, 27 shkurt - Ndeshja mes Istogut e Ferizajt e ka arsyetuar plotësisht epitetin e derbit. Istogu ka shënuar fitore me një gol dallim. Te fitorja, skuadra istogase ka ardhur me shumë mund dhe vetëm në momentet e fundit të ndeshjes. Ndeshja e xhiros së 14-të të Superligës së hendbollisteve përfundoi me rezultat 32:31 për Istogun. 14:14 ishte rezultati pas pjesës së parë. Ferizaj ishte në epërsi thuajse gjatë tërë pjesës së parë, por pas 30 minutave lojë shifrat ishin të barabarta. Lojë e njëjtë vazhdoi edhe në pjesën e dytë. Ferizajaset vazhdimisht ishin në epërsi prej një e dy gola. Vendaset arritën vetëm të barazojnë rezultatin, por jo të kalojnë në epërsi. Por fundi i ndeshjes ishte tregim tjetër. Në minutën e 57-të, Ferizaj shënoi gol për epërsinë 30:28. Më pas lojtaret e Istogut ia dolën të shënojnë katër gola për epërsinë e tyre prej 32:30. Krejt në fund Ferizaj shënoi edhe një gol për rezultatin final, 32:31 në të mirë të Istogut. Esma Muratoviq ka udhëhequr Istogun me 14 gola. Dajana Milaniq shtoi 8 gola. Albulena Kelmendi e braziliania Ligia Costa ishin më efikaset te Ferizaj me nga 8 gola. Për brazilianen ishte ndeshje debutuese dhe me të në përbërje, Ferizaj kishte fytyrë tjetër. Por skuadrën ferizajase sikur e lëshoi forca dhe koncentrimi në momentet e fundit. Te Ferizaj u dallua edhe portieria Veselinka Trenoska. Istogu vazhdon me bilanc të qind për qindtë në Superligë. Ka fituar 14 ndeshjet e deritashme dhe udhëheq në tabelë me 28 pikë. Ferizaj është i katërti me 20 pikë. Po të shtunën, Prishtina fitoi në udhëtim ndaj Vëllaznimit me rezultat 38:18. Ndërsa Jusuf Gërvalla e fitoi ndeshjen me Ulpianën me rezultat 30:22. Tri ndeshje tjera të javës së 14-të janë të dielën.



# Ballkani mposhti Dritën, Gjilani ndan pikët me Prishtinën

Prishtinë, 27 shkurt - Janë zhvilluar të dielën tri ndeshjet e fundit të javës së 22-të në BKT Superligë. Derbi i ditës ndërmjet Prishtinës dhe Gjilanit, i zhvilluar në stadiumin e qytetit në Suharekë, është mbyllur pa fitues 2-2. Gjilanasit ishin në epërsi prej 2-0 me golat e realizuar nga Gerhard Progni e Arbër Prekazi, mirëpo prishtinasit arritën të barazojnë shifrat në fund të ndeshjes me golat e Otto John dhe Endrit Krasniqi. Pas këtij barazimi Gjilani mbetet në pozitën e dytë, me 43 pikë, dy më pak se Ballkani, derisa Prishtina renditet e gjashta me 26 pikë. Ulpiana ka realizuar fitoren e parë pas tetë ndeshjeve dhe atë duke e mundur Drenicën, me rezultat 3-1. Golat e fitores për lipjanasit i shënuan Iran Goncalves (29'), Silvestre Shkalla (54') dhe Trimror Selimi (87'). Ndërkaq, golin e vetëm për Drenicën e shënoi Kreshnik Uka (96'). E fitore bindëse ka shënuar edhe Dukagjini si mysafir i Feronikelit, me shifrat 3-0. Joan Carioca, Ardin Dallku dhe Ahmed Januzi realizuan për fitoren e parë të Dukagjinit në pranverë. Ndërsa lideri i renditjes, Ballkani ka shënuar fitore të rëndësishme dhe atë si mysafir ndaj njërit prej konkurrentëve në garën për titull, Dritës, me rezultat 1-0. Theophilus Solomon realizoi golin e vetëm të ndeshjes në minutën e 70-të, pas asistimit të qendërmbrojtësit Bajram Jashanica. Pas kësaj fitoreje Ballkani arrin kuotën e 45 pikëve, derisa Drita mbetet në pozitën e tretë me 41 pikë. Në ndeshjen tjetër, Llapi ka triumfuar para tifozëve të vet në duel me Malishevën, me rezultat bindës, 3-0. Dy gola i realizoi Valmir Veliu në pjesën e parë (28' e 44') dhe një gol Arbnor Ramadani në pjesën e dytë (84'). Pas kësaj fitoreje llapjanët e përforcojnë pozitën e katërt me 39 pikë.



**SUPERLIGA - Java 22**

| | |
|---|---|
| Ulpiana - Drenica | 3-1 |
| Feronikeli - Dukagjini | 0-3 |
| Prishtina - Gjilani | 2-2 |
| Drita - Ballkani | 0-1 |
| Llapi - Malisheva | 3-0 |

**Tabela**

| | |
|---|---|
| 1. Ballkani | 45 pikë |
| 2. Gjilani | 43 |
| 3. Drita | 41 |
| 4. Llapi | 39 |
| 5. Drenica | 28 |
| 6. Prishtina | 26 |
| 7. Malisheva | 23 |
| 8. Ulpiana | 22 |
| 9. Dukagjini | 21 |
| 10. Feronikeli | 11 |

## FIFA vendos që asnjë ndeshje ndërkombëtare të mos zhvillohet në Rusi

Nyon, 27 shkurt - Shtëpia e madhe e futbollit botëror, FIFA ka dalë me një vendim ndaj Rusisë. FIFA ka vendosur që asnjë ndeshje ndërkombëtare të mos zhvillohet në Rusi. Kjo vjen si sanksion ndaj Rusisë, e cila nga e enjtja ka filluar ta sulmojë ushtarakisht Ukrainën. Po ashtu, flamuri dhe himni i Rusisë do të ndalohet gjatë ndeshjeve të kombeve tjera. Deri tani, një numër i madh i shteteve janë deklaruar se nuk dëshirojnë të luajnë ndaj Rusisë. Së fundmi, një gjë të tillë e konfirmoi edhe Anglia.



Sot me 28 shkurt 2022 u bënë tri vjet nga ndarja shumë e hershme
nga ne i dashuri ynë



# Dr. Abaz Cenë Krasniqi

(08.01.1979-28.02.2019)

Mungesën tënde e ndiejmë i madh e i vogël në familjen tonë.
Dhimbja nuk shprehet me fjalë e as lot, ajo është thellë në brendësin e shpirtit tonë.
Vdekja jote e hershme hapi një plagë të madhe në zemrat tona, që koha nuk shëron as sot as nesër as edhe për shumë mote.
Mungesa jote është zbrazëti që nuk plotësohet kurrë, ndërsa kujtimi dhe malli do të jenë pjesë e jetës sonë.
E madhe është krenaria që të patëm por edhe e madhe do të jetë dhimbja që nuk je me ne.

**Të përkujtojnë me mall: nëna Havë, vëllezërit, Isa, Ismeti, Fatoni motrat Eminja, Hysnija, Shkurta dhe Gjejrani si dhe nipat mbesat dhe mbarë farefisi nga Turjaka dhe Vranoci.**

U bënë tri vite pa më të dashurin tonë



# Dr. Abaz Cenë Krasniqi

(08.01.1979-28.02.2019)

U bënë tri vite vëllai im, kur vdekja e papritur të mori e të la çdo gjë në gjysmë, dhe ne mbetëm të jetojmë në trishtim, me plagë në zemër që nuk mbulohet, dhimbje që nuk shërohet, mungesë që nuk plotësohet, malli që nuk harrohet, mërzia që nuk largohet.
Ah ....sa e rëndë dhe e dhimbshme është të shkruash për ty, për valluan që aq shumë na mungon. Ne të ruajmë në thellësinë tonë, të ndjejmë e të shtrëngojmë fort, në vete në çdo hap deri në fund të kësaj jete, kurse ti je engjëlli ynë që shpesh herë në ëndërr vjen e na përqafon. Ishte krenaria jonë, ashtu do të mbetesh deri sa, dhe ne një ditë do t'i mbyllim sytë me shpresën se do të takojmë në parajsë.

**Me shumë mall e zjarr në zemër të kujtojmë: motra Eminja, nipat Dukagjini, Durimi, Driloni dhe dhëndri Tahiri.**

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**
**Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat**

Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020 si dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 193/2021 të datës 26 Mars 2021, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

# K O N K U R S

## I. Administrator i Lartë i TI-së për Baza të të Dhënave

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, dy (2) pozita

| | |
|---|---|
| Referenca: | KPK/SKPK/POZ-001 |
| Emri pozitës: | Administrator i lartë i TI-së për Baza të të Dhënave |
| Pozita: | Pozitë e karrierës |
| Niveli : | Profesional |
| Raporton tek: | Udhëheqësi i Divizionit |
| Kodi i punës: | TIK/190 |
| Numri i Pozitave: | Dy (2) pozita |
| Koeficienti: | nëntë (9) |
| Akt emërim: | Pa afat |
| Puna provuese: | 12 muaj |
| Vendi: | Prishtinë |

**Qëllimi i vendit të punës:**
Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Divizionit për Sisteme Elektronike (softuer), Administratori i lart TI-së për baza të të dhënave është përgjegjës për administrimin e gjitha aplikacioneve në sistemin prokurorial, zhvillim të procedurave për masat e sigurisë së aplikacioneve dhe funksionim të tyre.

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore**:
Zhvillon dhe implementon aplikacionet/module te reja, sistemet softuerike, dhe/ose përmirësimin e aplikacionit ekzistuese në kuadër të SKPK-se;
Instalon, konfiguron dhe administron në mënyrë efektive ueb serverët;
Kryen veprime të përditshme të zhvillimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të sistemeve, duke përfshirë edhe funksionet e administrimit të bazës së shënimeve, konfigurimin dhe përshtatjen/akordimin e performances së aplikacioneve dhe bazave të shënimeve të aplikueshme në sistemin prokurorial;
Siguron mirëmbajtjen dhe mbështetjen teknike për sistemet duke përfshirë përcaktimin dhe korrigjimin e problemeve teknike;
Kryen instalimin e sistemeve dhe bazave të shënimeve duke përfshirë instalimin dhe konfigurimin e komponentëve të anës së klientit.
Negocion ne mes të përdoruesve të sistemeve dhe bazave të shënimeve dhe ofruesve të jashtëm të shërbimeve në mënyrë që të arrihet një zgjidhje e shpejte e problemeve. Ofron asistence teknike dhe trajnime për përdoruesit fundor.
Asiston gjatë procesit të përzgjedhjes dhe të analizës të punës së sistemeve apo bazave të shënimeve të reja, ridisenjimin, plotësimin me të dhëna dhe uljen/reduktimin e duplifikimit të të dhënave, çështjet e krijimit dhe te integrimit. Bënë administrimin e ueb aplikacioneve, merret me ngjarjet (events), mbështetjen, kopjet rezerve (back up) dhe rikthimin (recovery) e tyre në funksion;
Kujdeset për të rregulluar punën e regjimit të sigurisë së aplikacioneve, zbulimit eventual të ndërhyrjeve pa leje dhe sanimit që shkaktohen nga këto ndërhyrje në sistemet e TI-së. Përgatit dokumentacionin e sistemit, udhëzimet punuese dhe procedurat standarde të punës në bashkëpunim të ngushtë me palët tjera përkatëse të kyçura;
Të siguroje që procedurat e testimit janë të përcaktuar/definuar, të dokumentuara dhe të zbatueshme.
Analizon dhe vlerëson proceset e punës se rregullt që duhet të kryhet.
Kryen çdo detyre tjetër që korrespondon ose mund te ndihmoje në kryerjen e funksioneve te administratorit të bazës së të dhënave për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e funksioneve të infrastrukturës se sistemeve. Kryen çdo detyre tjetër që korrespondon ose mund te ndihmoje në kryerjen e funksioneve te administratorit të bazës së të dhënave për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e funksioneve të infrastrukturës se sistemeve.

**Njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë për vendin e punës:**
Certifikata për zhvillimin e aplikacioneve ne platformën e Microsoft apo te ngjashme - përparësi;
në programim si në: Java, ASP.Net, C#, VB.Net, XML , Web Services , HTML dhe platforma të tjera të njohura në web;
Kuptoj dhe mbështes përkthimin e kërkesave funksionale të sistemeve në prokurori ;
Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;

**Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:**
Diplomë Universitare në Inxhinieri Kompjuterike ose Shkenca Kompjuterike.

**Përvoja e Punës**:
Tri (3) vite përvojë punë në fushën e TI-së.

## II. Zyrtar për Përkthime (shqip serbisht dhe anasjelltas), dy (2) vende pune

Prokuroria Themelore në Prishtinë një (1) pozitë
Prokuroria Themelore në Mitrovicë një (1) pozitë

| | |
|---|---|
| Referenca: | KPK/ZKPSH/SKPK/PA/PSRK/PTH/POZ- 002 |
| Emri Pozitës: | Zyrtar për Përkthime (shqip serbisht dhe anasjelltas) |
| Pozita: | Pozitë e karrierës |
| Niveli: | Profesional |
| Kodi i punës: | IN/040 |
| Raporton tek: | Administratori i Prokurorisë |
| Numri i Pozitave: | Dy (2) pozita |
| Koeficienti: | Shtatë (7) |
| Akti i emërimit: | Pa afat |
| Puna provuese: | 12 muaj |
| Vendi: | Prishtinë, Mitrovicë |

**Qëllimi i vendit të punës:**
Ofron përkrahje të gjerë administrative dhe teknike për stafin Profesional të një njësie organizative në fushën kryesore të punës, për përkthimin e të gjitha materialeve, duke siguruar përkthim cilësor.

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**
Bën përkthim profesional të materialeve të shkruara nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas.
Bën përkthim profesional simultan në takimet e ndryshme;
Përgjegjës për respektimin e afateve dhe për saktësinë e përkthimeve që kryen;
Merr përgjegjësi specifike lidhur me përkthimin e materialeve që kërkohen nga institucioni;
Është përgjegjës për përkthimin e dokumenteve dhe ruajtjen e konfidencialitetit te njëjtave;
Kontrollon/Lekturon materialet e përkthyera dhe është përgjegjës për përkthim cilësor, si me shkrim, konsekutiv dhe simultan;
Mbanë evidencën e saktë e të plotë të aktiviteteve, dosjeve, punimeve, dokumenteve zyrtare, përfshirë përgatitjen e raporteve për tërë punën e kryer;
Kryen edhe detyra tjera të punës në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

**Njohuritë, shkathtësitë aftësitë për vendin e punës:**
Shkathtësi të shkëlqyera të njohjes së gjuhës gjatë komunikimit me gojë dhe me shkrim;
Njohuri të mirë në të shkruar të gjuhës Shqipe dhe Serbe;
Njohja e punës me kompjuter (Word dhe Excel).

**Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:**
Diplomë Universitare**.**

**Përvoja e Punës:**
Dy (2) vite përvojë pune.

- *Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe në gazetat ditore, duke filluar nga data* ***28.02.2022 deri me datë 14.03.2022*** *si datë e mbylljes së konkursit.*
- *Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen:* ***www.prokuroria-rks.org***
- *Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati VII, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë.*
- *Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", nr. 100, Kati 7, zyra nr. 702, 10000 Prishtinë.*
- *Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.*
- *Në rast nevoje mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 18874 prej orës 08:00 – 16:00.*
- *Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:*
  - *Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.*
  - *Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.*
  - *"Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."*
- *Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e skanuara të dokumentacionit të kërkuar:*
  - *Dëshminë e kualifikimit shkollor;*
  - *Dëshmi mbi përvojën e punës, Vërtetimi dhe kontrata e punës (Letër Referenca apo Rekomandimi nuk pranohet si dëshmi mbi përvojën e punës);*
  - *Dy rekomandime (nëse keni);*
  - *Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);*
  - *Dokumentin e identifikimit–letërnjoftimi i fotokopjuar;*
  - *Certifikatë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.*
- *Në lidhje me datën e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, kandidatët do të njoftohen bazuar në legjislacionin ne fuqi.*

Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

Na osnovu člana 31 Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, na osnovu Zakona br.03/L-149 o Civilnoj službi Republike Kosova i Pravilnika br. 02/2010 o Postupku Zapošljavanja u Civilnoj Službi Kosova, u skladu sa Presudom br. Ref AGJ.1583/20 od 09. jula 2020. godine kao i Odluke Tužilačkog Saveta Kosova KPK/br. 193/2021 od 26. marta 2021. godine, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova ponovno objavljivanje:

# K O N K U R S

**I. Viši Administrator IT –a za Baze Podataka**
Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, dve (2) pozicije

| | |
|---|---|
| Referenca: | KPK/SKPK/POZ – 001 |
| Naziv pozicije: | Viši Administrator IT –a za Baze Podataka |
| Pozicija: | Pozicija od karijere |
| Funkcionalna kategorija: | Profesional |
| Raportira kod: | Rukovodilac Divizije |
| Poslovni Kod: | TIK/190 |
| Broj Pozicija: | Dve (2) pozicija |
| Koeficijenat: | 9 |
| Akt o imenovanju: | Na neodređeno |
| Probni Rad: | Dvanaest (12) meseci |
| Mesto: | Priština |

**Cilj radnog mesta:**
Pod nadzorom šefa Odseka za Elektronske Sisteme (softver), Viši Administrator IT-a za Baze Podataka odgovoran je za upravljanje svim aplikacijama u sistemu tužilaca, razvijanje procedura za mere sigurnosti aplikacija i njihovo funkcionisanje.
**Glavne obaveze i odgovornosti:**
Razvija i implementira nove aplikacije/module, softverske sisteme i/ili ispravljanje postojeće aplikacije u okviru STSK-a;
Instalira, konfiguriše i upravlja veb servere na efektivan način;
Obavlja svakodnevne operacije razvoja sistema, održavanja i upravljanja sistema, uključujući funkcije administracije baze podataka, konfiguraciju i prilagođavanje/akordiranje performanse aplikacija i baze podataka primenljive na tužilačkom sistemu ;
Obezbeđuje održavanje i tehničku podršku za sisteme uključujući određivanje i ispravljanje tehničkih problema;
Obavlja instalaciju sistema i baze podataka uključujući instalaciju i konfiguraciju komponenti za klijente;
Pregovara između korisnika sistema i baze podataka i spoljnih provajdera za usluge kako bi se došlo do brzog rješavanja problema. Pruža tehničku pomoć i obuku za krajnje korisnike.
Pomaže tokom procesa izbora i analize rada novih sistema ili baze novih podataka, redizajniranja, dopunjavanja podataka i smanjenja / reduktovanja dupliranja podataka, pitanja stvaranja i integracije.
Upravlja veb aplikacijama, bavi se događajima, podrškom, rezervnim kopijama (back up) i njihovo ponovno vraćanje u funkciji (recovery);
Pobrine se da uređuje rad režima aplikacijskih sigurnosti, eventualnog otkrivanja neovlašćenih intervencija i saniranja koja se uzrokuju ovim intervencijama u sistemima IT-a.
Priprema dokumentaciju sistema, radna upustva i standardne radne procedure u uskoj saradnji sa ostalim relevantnim strankama koje su uključene;
Obezbediti da procedure testiranja su određene/definisane, dokumentovane i sprovodne.
Analizira i ocenjuje procese redovnog rada koji se treba obavljati.
Obavlja svaki zadatak koji odgovara ili može pomoći u obavljanju funkcija administratora baze podataka kako bi povećao efikasnost i efektivnost funkcija sistemskih infrastruktura.
**Znanja, veštine i iskustva za radno mesto:**
Sertifikat za razvoj aplikacija na Microsoft platformi ili slično;
Iskustvo u programiranju: Java, ASP.Net, C #, VB.Net, KSML, Veb usluge, HTML i druge poznate platforme na vebu;
Razumjeti i podržati prevod funkcionalnih zahteva sistema u tužilaštvo;
Veliko znanje u specifičnu stručnu oblast stečeno kroz univerzitetsko obrazovanje i odgovarajuću obuku;
Istraživačke, analitičke, evaluacijske veštine i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
**Stručna sprema i kvalifikacije:**
Univerzitetska Diploma Kompjuterske Inžinjerije ili Kompjuterskih Nauka.
**Radno iskustvo:**
Tri (3) godine radnog iskustva u oblasti IT-a.

**II. Službenik za Prevođenje, (albanski – srpski i obrnuto)**
Osnovno Tužilaštvo Priština, jedna (1) pozicija
Osnovno Tužilaštvo Mitrovica, jedna (1) pozicija

| | |
|---|---|
| Referenca: | KPK/ZKPSH/SKPK/PA/PSRK/PTH/POZ- 002 |
| Naziv pozicije: | Službenik za Prevođenje |
| Pozicija: | Pozicija od karijere |
| Nivo: | Profesional |
| Raportira kod: | Administrator Tužilaštvo |
| Poslovni Kod: | IN/040 |
| Broj pozicija: | Dve (2) pozicije |
| Koeficijenat: | Sedam (7) |
| Akt Imenovanja: | Na neodređeno |
| Probni Rad: | Dvanaest (12) meseci |
| Mesto: | Priština, Mitrovica |

**Cilj radnog mesta:**
Pruža široku administrativnu i tehničku podršku za Profesionalno osoblje jedne organizativne jedinice iz ključne radne oblasti, za prevođenje svih materijala, obezbedeći kvalitetan prevod.
**Glavne dužnosti i odgovornosti:**
Vrši profesionalni prevod pisanog materijala sa albanskog jezika na srpski jezik i obratno;
Vrši profesionalno simultan prevod na raznim sastancima ;
Odgovoran je za poštovanje rokova i tačnosti prevoda koje vrši;
Snosi specifičnu odgovornost u vezi prevoda materijala koji se zahtevaju od strane institucije;
Odgovoran je za prevođenje dokumenata i očuvanje tajnosti istih;
Kontroliše/Lektoriše prevođeni materijal i odgovoran je za kvalitativan prevod, pismeno, konsekutivno i simultano;
Održava tačnu i potpunu evidenciju aktivnosti, dosijea, radova, službenih dokumenata, uključujući i pripremu izveštaja za izvršeni rad;
Obavlja i ostale radne dužnosti u skladu sa aktualnim zakonima i pravilnicima koje se mogu zatražiti na opravdan način i povremeno.

**Znanja, veštine i sposobnosti za radno mesto:**
Odlične veštine u poznavanju jezika tokom usmenog i pismenog komuniciranja- prioritet.
Dobro poznavanje Albanskog i Srpskog jezika u pismenoj formi.
Poznavanje rada sa kompjuterom (Word i Excel).

**Stručna sprema i kvalifikacije:**
Univerzitetska Diploma.
**Radno iskustvo:**
Dve (2) godine radnog iskustva.

---

- *Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja na službenoj stranici Tužilačkog Sistema Kosova, kao i u dnevne novine, počevši od* ***28.02.2022 do 14.03.2022*** *kao datum isteka konkursa.*
- *Prijava (aplikacije) za zaposlenje dostupna je na Internetu: www.prokuroria-rks.org*
- *Aplikacije se predaju svakog radnog dana od 08:00 do 16:00, u Diviziji Ljudskih Resursa, VII sprat, Kancelarija br. 702, Priština, Kosovo.*
- *Prijava poštom: Zahtevi popunjeni dokumentima takođe se mogu predati poštom Odeljenju za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Rr. „Luan Haradinaj“, br. 100 Sprat 7, kancelarija br. 702, 10000 Priština.*
- *Aplikacije poslate putem pošte, koje sadrže poštanski pečat nad pošiljkom sa datumom poslednjeg dana roka za apliciranje, smatraće se važečim i uzeće se na razmatranje, ako stižu u roku od 4 dana, aplikacije koje stižu posle ovog roka ili su nekompletirane neče se uzeti u obzir uopšte.*
- *U slučaju potrebe možete da nas kontaktirate na, tel: 038 / 200 18874 od 08:00 do 16:00 časova.*
- *Uslovi učešća na konkursu:*
  - *Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost delovanja, poseduju civilna i politićka prava, imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za vršenje dužnosti kao i fizičkih sposobnosti koja se traže za dotičnu poziciju.*
  - *Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža jednake mogučnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije od sviju osoba muškog i ženskog pola iz redova svih zajednica na Kosovu.*
  - *"Nevečinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe centralne i lokalne državne administracije kao što je specifikovano članom 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova".*
- *Aplikacijama se moraju sastaviti kopije zatražene dokumentacije:*
  - *Svedočanstvo školske spreme;*
  - *Dokaz o radnom iskustvu; Potvrda i radni ugovor (Referentno pismo ili preporuka se ne prihvataju kao dokaz radnog iskustva).*
  - *Dve preporuke (ako imate);*
  - *Kopije dva poslednja naizmenična izveštaja procene rada (ako takvi postoje);*
  - *Dokument identifikacije–fotokopirana lična karta;*
  - *Uverenje od Suda da niste pod istragom.*
- *U vezi datuma održavanja pismenog testa i intervjua, za kandidate koji ispunjavaju uslove koji su predviđeni na osnovu ovog konkursa, kandidati biće obavešteni na osnovu važečeg zakonodavstva.*










## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Haxhi Isufi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollë fillore “Ahmet Rrustemi” Bec, Gjakovë.

▶ Hatmon Isufi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Ahmet Rrustemi”, Gjakovë.

▶ Fjolla Emra nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së fillore nga klasa e –I- deri në të –VIII-tën shkolla “Yll Morina” Gjakovë.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100% mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues